

## NË EMER TE POPULLIT

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, ne çeshtjen penale te te pandehurit A.R. nga ..., per shkak te vepres penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se, sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krimet e Renda, PP. I.nr.09/18, e dt. 18.01.2018, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar dhe publik me dt.23.01.2018, shpalle:

## AKTGJYKIM

Ndaj te pandehurit **A.R. nga** babai Z. nëna F., i lindur me dt. Data e lindjes... ne ..., me vendbanim jeton ne fshatin ..., Komuna e ... dhe ne shtetin e Finlandws, i divorcuar, me profesion hotelier ne shtetin e ..., i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikes se Kosoves.

## ËSHTE FAJTOR

Sepse, me date 16.01.2018 rreth ores 00:30, ne ... rr `` ... `` perball kafiterise ..., i pandehuri ne vend public ku kishte grumbull te madh te njerezve-qytetareve pa autorizim dhe ne kundershtrim me ligjin e zbatueshem lidhur me armet, ka mbajtur ne pronesi armen e zjarrte dhe ate nje revole te markes `` ... `` e kalibrit 9mm dhe me te verejtur zyrtaret policor ishin ne vezhgim, i njejti nga brezi e ka nxjerre armen dhe e ka hudhur ne toke, pasi qe e kane verejtur zyrtaret policor e njejta arme ne fjale eshte sekuestruar.

-me qka ka kryer veper penale penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se.

Andaj ne baze te nenit 4,41,42,43,46,69,73,74,75,76 dhe nenit 365, 450 te KPPK-se, e

## E GJYKON

**Me denim me gjobë ne shume prej 400 €( katwrqindw euro) , te cilin gjobe I pandehuri do ta paguaj ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi, ne te kunderten ky denim me gjobe do te shndërrohet ne denim me burg, ashtu që per çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 ( një) ditë burgim.**

Obligohet i pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqesor, ksaj gjykate ti paguaj Shumen prej 20 euro, ndersa shpenzimet e procedures do te paguhen sipas llogarise perfundimtare te ksaj gjykate.

**Konfiskohet: Arma e zjarrtw e markws `` ... `` e kalibrit 9mm.**

## **A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda, me dt. 18.01.2018, ka ngritur aktakuzen PP/I, nr.09/ 18, ndaj te akuzuarit A.R. per shkak te vepres penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se, duke kërkuar që pas mbajatjes se shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, i pandehuri te shpallet fajtor dhe te denohet me denim meritor sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datëm 23.01.2018, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri A.R. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranon fajësin për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publik kryetari i trupit gjykues pas degjimit të të pandehurit dhe prokurorit te shtetit, ka marr aktvendim me te cilin ka pranuar pranimin e fajesis, nga se janë plotesuar kushtet ligjore dhe ky pranim i fajsisë është ne perputhje me provat qe gjinden ne shkresat e lendes edhe ate: Raporti i Oficerit, deklarata e te panndehurit dhene ne stacionin policor dhe ne prokurori, informacionet e personit, akti percjelles, raporti fillestar i incidentit, deklarata e deshmitarit T.Gj., foto dokumentacioni, deftese mbi konfiskimin e prones, formular prone-dwshmie, aktvendim mbi ndalimin e personit, raporti i oficerit, raport i shpejtw, si dhe shkresat e tjera te lendes.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis, pranimi është bere vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbeshtet ne faktet e çeshtjes qe permban aktakuza dhe se e njëjta nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, konform dispozitave 73 dhe 74, dhe 76 të KPRK-se, gjykata ka marr për bazë rrethanat që ndikojn në llojin dhe lartësin e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethan

lehtësuese për të pandehurin ka marrë pranimin e fajësisë, është baba i katër femive, njëkohsisht është edhe pensioner, është penduar dhe ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i premton gjykatë që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, ndërsa gjykata nuk gjeti rrethana rënduese për të pandehurin.

Sipas Kryetarit të Trupit Gjykses, dënimi me gjobë në shumë prej 300 euro është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe gjendjen financiare të tij, andaj konform nenit 41 të KPRK-se gjykata vlerëson se me këtë dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e kryesit që në të ardhmen të kryej vepra tjera penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-se, të pandehurit i ka konfiskuar pushkën e markës “pushkë të gjuetis dy tyteshe prodhim i brazilit me nr. serike. ....

Kryetarit i trupit gjykses ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t’ia paguaj Shumen paushalle në vlerë prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**  
**Me dt. 04.01.2018**

**Zyrtare ligjore,**  
**Zahide Rexhepi**

**Kryetari i trupit gjykses:**  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** Kunder këtij aktgjykimi, palet e paknaqura mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.